



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit: "Media Servis" SH.P.K.

Numri i Biznesit: - 71240053

Pronar: Sabit BALLABANI

OSHMA: TV PREMIUM

Adresa: Rr/ Shaqir Igrisht 3/5, Mati 1, Prishtinë


VENDIM

për ndërprerjen e vendimit për licencimin e Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes sistemit të operatorëve të shpërndarjes TV Premium – me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2017/02, ka hyrë në fuqi më 25 janar 2017, ndërsa, me Kreun III të kësaj rregulloreje, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale të cilët transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes, e që do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtjesore dhe t'i transmetojnë ato përmes cilit do operator të shpërndarjes.
3. Më datën 8 shkurt 2016, kandidati TV Premium ka aplikuar për licencë të KPM-së për të operuar si ofrues i shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) me transmetim përmes sistemit të operatorit të shpërndarjes.
4. Më datën 9 mars 2016, Komisioni ka marr vendim për licencimin e OSHMA TV Premium - Vendimi me numër të referencës 1603/260/LIC/ni, si ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) për transmetim përmes sistemit të operatorit të shpërndarjes, me afat të licencës prej dhjet (10) viteve.


Arsyetim



5. Komisioni vlerëson se, OSHMA TV Premium, duke mos u pajisur me pakon e Licencës edhe pas udhëzimeve të KPM-së, nuk ka shprehur interesim për fillimin e aktiviteteve të transmetimit.
6. Komisioni konstaton se, pas përcjelljes së vendimit për licencim të OSHMA TV Premium përmes e-maili, me datën 29 mars 2016, nga Zyra Ekzekutive e KPM-së, poashtu përmes e-mail-i i licencuari ka konfirmuar pranimn e vendimit më datën 29 mars 2016.
7. Komisioni konstaton se, Zyra Ekzekutive e KPM-së, me datën 30 mars 2016, përmes e-maili i ka përcjellë OSHMA TV Premium dokumentin – Formatin e Programit dhe e ka udhëzuar për plotësim e tij, në pajtim me skemën programore të dorëzuar me rastin e aplikimit për licencë. Gjithashtu, kandidati është kontaktuar përmes telefoni nga Departamenti i Licencimit si dhe ka zhvilluar edhe një takim në Zyrën Ekzekutive të KPM-së për këtë qëllim, mirëpo i licencuari nuk ka arritur të veproj sipas udhëzimeve të KPM-së.
8. Me qëllim të paisjes së OSHMA TV Premium me pakon e Licencës së KPM-së, Komisioni konstaton se Zyra Ekzekutive ka provuar edhe disa herë me radhë për të kontaktuar me pronarin lidhur me këtë çështje, duke i dërguar e-mail si dhe duke provuar që të kontaktoj përmes telefoni, mirëpo ka hasur në vështërsi që të kontaktoj me të licencuarin.
9. Komisioni vlerëson se, i licencuari përfundimisht ka dështuar të veproj sipas udhëzimeve të KPM, duke mos u pajisur me Pakon e Licencës të KPM-së dhe në këtë mënyrë OSHMA TV Premium, nuk ka shprehur interesim që të ushtroj aktivitetin e transmetimeve televizive përmes sistemit të operatorëve të shpërndarjes.

Vendim

10. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur me datën 15 dhjetor 2020, merr vendim për ndërprerjen e vendimit për licencimin e Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes sistemit të operatorëve të shpërndarjes OSHMA TV Premium - Vendimi me numër të references 1603/260/LIC/ni.
11. Komisioni, merr vendim që obligimet financiare të të licencuarit OSHMA TV Premium të kryhen në pajtim me Legjislacionin në fuqi.
12. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.


Xhevat LATIFI
Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



15.12.2020
datë